



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 22, datë 09 .04. 2013

PËR

**“NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.8, DATË 12.10.2011
PËR “MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE TË APARATIT TË BASHKISË
SË TIRANËS” (I NDRYSHUAR)”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 32, shkronja “ç”, nenit 33, pika 6 të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore” (i ndryshuar); nenit 128 të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi Punës në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); ligjit nr.9131, datë 08.09.2003 për “Rregullat e Etikës në Administratën Publike”; nenit 5, shkronja “a” dhe “b” të ligjit nr.10405 datë 24.3.2011, për “Kompetencat për caktimin e pagave të punës”; nenit 10, nenit 11, pika 2 të ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1619, datë 02.07.2008, për “Klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njërive të qeverisjes vendore, për efekt page, dhe për caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore” (i ndryshuar); nenit 14, nenit 15, pika 7 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.505, datë 01.08.2007 “Për miratimin e statutit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit”; vendimin e Këshillit Bashkiak nr.53, datë 24.12.2012 për “Miratimin e programitbuxhetorafatmesëm 2013-2015 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2013” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit Bashkiak nr.8, datë 12.10.2011 për ”Miratimin e strukturës organizative të aparatit të Bashkisë së Tiranës” (i ndryshuar), nenit 3 të Akt – Marrëveshjes nr.124, datë 08.10.2007 midis Bashkisë së Tiranës dhe Qendrës Kombëtare të Regjistrimit; me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë një shtesë dhe ndryshim në pikën 2, paragrafin 2 të vendimit të Këshillit Bashkiak nr.8, datë 12.10.2011 për ”Miratimin e strukturës organizative të aparatit të Bashkisë së Tiranës” (i ndryshuar), me përmbajtje si më poshtë:

- Punonjës të aparatit të Bashkisë	491
- Punonjës të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit	7
2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Drejtoria e Financës, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

Niazi KOSOVRASTI